

Treguesit demografikë


Tremujori II – 2021

Tiranë, më 12 gusht 2021: Numri i lindjeve për tremujorin e dytë 2021 është 5.993, duke shënuar një rënie me 10,6 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2020.

Numri i vdekjeve për tremujorin e dytë 2021 rezulton 5.777, duke shënuar një rritje prej 7,3 %, krahasuar me tremujorin e dytë 2020.

Shtesa natyrore e popullsisë (diferenca midis lindjeve dhe vdekjeve) në tremujorin e dytë 2021, pësoi rënie, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020: nga 1.320 në 216 në 2021.

Fig. 1: Shtesa natyrore e popullsisë




**Të dhëna paraprake

Për publikim: 12 gusht 2021

Në tremujorin e dytë 2021 pesë qarqe të vendit shënuan shtesë natyrore pozitive të popullsisë, ndërsa në shtatë qarqet e tjera, shtesa natyrore e popullsisë është negative.

Në tremujorin e dytë 2021 vlera më e lartë e shtesës natyrore regjistrohet në qarkun e Tiranës, ku numri i lindjeve tejkalon me 590 numrin e vdekjeve, ndërsa ai më i vogël regjistrohet në qarkun e Korçës, ku vdekjet tejkalojnë me 205 numrin e lindjeve.

Fig. 2: Lindjet, vdekjet dhe shtesa natyrore sipas qarkut, T2 – 2021**



**Të dhëna paraprake

Lindjet

Në tremujorin e dytë 2021 dy qarqe të vendit kanë shënuar rritje të numrit të lindjeve, ndërsa në dhjetë të tjerat numri i lindjeve është ulur, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Në tremujorin e dytë 2021 numri më i madh i lindjeve regjistrohet në qarkun e Tiranës, me 1.999 lindje, ndërsa ai më i vogël në qarkun e Gjirokastrës, me 92 lindje.

Rritjen më të madhe në përqindje të lindjeve, gjatë tremujorit të dytë 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 e zë qarku i Kukësit, me 11,5 %.

Uljen më të madhe në përqindje të lindjeve, gjatë tremujorit të dytë 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 e zë qarku i Gjirokastrës, me – 31,3 %.

Tab. 1: Lindjet sipas qarkut

Nr.	Qarku	II - 20	III - 20	IV - 20	**I - 21	**II - 21
	Shqipëria	6.706	8.007	7.011	6.006	5.993
1	Berat	250	292	249	262	216
2	Dibër	390	451	389	360	365
3	Durrës	680	872	781	636	638
4	Elbasan	652	739	709	560	511
5	Fier	596	721	689	526	528
6	Gjirokastrë	134	150	125	113	92
7	Korçë	454	482	369	357	380
8	Kukës	183	268	267	178	204
9	Lezhë	308	370	299	295	283
10	Shkodër	430	512	483	432	479
11	Tiranë	2.200	2.751	2.307	2.020	1.999
12	Vlorë	322	368	323	254	280
	<i>*Të panjohur</i>	107	31	21	13	18

*Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e lindjeve të gjalla për të cilat informacioni i qarkut, ku është regjistruar lindja mungon.¹

**Të dhëna paraprake

Vdekjet

Në tremujorin e dytë 2021 tre qarqe të vendit kanë shënuar ulje, ndërsa nëntë qarqet e tjera kanë shënuar rritje të numrit të vdekjeve, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2020.

Në tremujorin e dytë 2021 numri më i vogël i vdekjeve regjistrohet në qarkun e Kukësit, me 125 vdekje, ndërsa ai më i madh në qarkun e Tiranës, me 1.409 vdekje.

Uljen më të madhe në përqindje të vdekjeve, gjatë tremujorit të dytë 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 e zë qarku i Lezhës, me - 14,8 %.

Rritjen më të madhe në përqindje të vdekjeve, gjatë tremujorit të dytë 2021, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2020 e zë qarku i Beratit, me 18,4 %.

¹ Shiko metodologjinë në linkun në vijim:

<http://www.instat.gov.al/al/temat/treguesit-demografik%C3%AB-dhe-social%C3%AB/lindjet-vdekjet-dhe-martesat/#tab4>

Tab. 2: Vdekjet sipas qarkut

Nr.	Qarku	II - 20	III - 20	IV - 20	**I - 21	**II - 21
	Shqipëria	5.386	6.624	9.397	9.657	5.777
1	Berat	272	305	500	529	322
2	Dibër	214	281	307	370	206
3	Durrës	483	618	918	925	492
4	Elbasan	535	632	923	929	566
5	Fier	569	695	1.147	1.165	666
6	Gjirokastër	188	212	297	281	219
7	Korçë	510	597	837	708	585
8	Kukës	138	153	199	168	125
9	Lezhë	271	326	423	433	231
10	Shkodër	457	618	781	637	499
11	Tiranë	1.339	1.764	2.504	2.701	1.409
12	Vlorë	408	414	558	805	453
	<i>*Të panjohur</i>	2	9	3	6	4

*Kategoria "Të panjohur" nënkupton numrin e vdekjeve për të cilat informacioni i qarkut, ku është regjistruar vdekja mungon.

**Të dhëna paraprake

Metodologjia

Të dhënat tremujore për lindjet dhe vdekjet, në nivel kombëtar dhe qarku përbëjnë një hallkë të rëndësishme të demografisë së vendit. Ato paraqesin të dhëna mbi ndryshimet në popullsi, të cilat kanë impakt në jetën ekonomike dhe sociale të vendit. Këto të dhëna publikohen mbështetur në Programin e Statistikave Zyrtare 2017-2021.

Lindjet

Të dhënat e lindjeve:

Të dhënat e lindjeve, sipas karakteristikave bazë demografike sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e lindjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha lindjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh lindjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile, pranë ish-vendbanimeve të tyre.

Regjistrimet e vona të lindjeve

Kryhet një rregullim i vogël i numrit të lindjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha lindjet e ndodhura në periudhën referencë.

Numri i lindjeve të regjistruara vonë nga viti i mëparshëm, janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të lindjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

Vdekjet

Të dhënat e vdekjeve

Të dhënat e vdekjeve, sipas karakteristikave bazë demografike sigurohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, e cila dërgon në INSTAT vetëm numrin e vdekjeve të banuesve në Shqipëri. Konsiderohen të gjitha vdekjet e banuesve në Shqipëri gjatë periudhës referencë, duke mos marrë parasysh vdekjet e banuesve jashtë Shqipërisë (emigrantëve), edhe pse mund të regjistrohen në zyrat e gjendjes civile pranë ish-vendbanimeve të tyre.

Regjistrimet e vona të vdekjeve

Bëjmë një rregullim të vogël të numrit të vdekjeve që regjistrohen vonë për vitin aktual, në mënyrë që të përfshijmë të gjitha vdekjet e ndodhura në periudhën referencë.

Numri i vdekjeve të regjistruara vonë nga viti i mëparshëm, janë konsideruar si një proxy për regjistrimet e vona të vitit aktual, duke konsideruar supozimin (si rezultat edhe i analizave tona të vazhdueshme) që numri i regjistrimeve të vona të vdekjeve nuk ndryshon shumë nga viti në vit.

Përkufizime:

Shtesa natyrore e popullsisë: Shpreh rritjen/rënien e popullsisë, si rezultat i proceseve biologjike (lindjeve dhe vdekjeve) të saj, gjatë një periudhe kohe. Ky tregues shprehet si diferencë ndërmjet lindjeve dhe vdekjeve.

Lindje e gjallë: Lindjet e fëmijëve që shfaqën shenja jete.

Vdekje: Nënkupton zhdukjen e përhershme të të gjitha shenjave të jetës, në çdo kohë pasi ka ndodhur një lindje e gjallë (ndërprerjen e funksioneve vitale, pa aftësinë e ringjalljes).